



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr. 490/2 prot.

Tiranë, më 24.02.2020

**Lënda: Raport i mbledhjes së Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.**

Më datë 7.02.2020, ora 14.00, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u zhvillua mbledhja e radhës së KMR-së me këtë rend dite:

- 1- Diskutim dhe miratim i aplikimeve për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues
- 2- Diskutim dhe miratim i aplikimeve për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues
- 3- Njohje e kompanisë Exitron për kontroll teknik dhe shërbimin e dozimetrisë personale si dhe rishikim për kompaninë Ednafarma.
- 4- Diskutim i kërkesave për njohje si ekspert i kualifikuar në fushën e mbrotjes nga rrezatimet jonizuese.
- 5- Diskutim mbi tarifatat për amendimet në stacionet bazë të telefonisë celulare.
- 6- Diskutim dhe miratim i listave të kontrollit për procesin e inspektimit në ZMR
- 7- Miratim mbi mbështetjen për realizmin e temës për studenten nga Fakulteti i Mjekësisë
- 8- Informacion mbi seancat gjyqësore me Teuta 2
- 9- Informacion mbi kërkesat e reja për mbrotjen nga rrezatimet me shtimin e rrjeteve. Përcaktimi më i qartë i të dhënave që do shoqërojnë aktin e miratimit.
- 10- Informacion mbi letrën e QSUT për vendosjen e një stacioni bazë në ambientet e QSUT.
- 11- Diskutim dhe miratimi në parim i rregullores mbi "Cmontimin e qendrave që përdorin burime të rrezatimit jonizues"
- 12- Diskutim për miratimin e kërkesës për leje importi të Policisë së Shtetit
- 13- Ndjekja nga ana e Drejtorisë Juridike në MSHMS të marrëveshjes me MB dhe VKM me Policinë e Shtetit
- 14- Plotësimi i vendit bosh në KMR.

Në mbledhje morën pjesë: Znj. Ogerta MANASTIRLIU, Kryetar i KMR-së, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Z. Rustem PACI, Sekretar i KMR-së, Znj. Antoneta NJEHRRENA, Znj. Albana FICO, Z. Shkëlqim MEMA, Z. Jetmir BRAHA anëtarë të KMR si dhe protokolluesja, Znj. Ida MURAJ. Z Sykja kishte konfirmuar që s' do të jetë më pjesë e KMR.

Mbledhja u hap nga Kryetari i KMR-së Znj. Manastirliu sipas rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës: Diskutim dhe miratim i aplikimeve për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues.

*Manastirliu*

Lidhur me këtë çështje, Z. Paci sqaroi se kërkesa për ndryshimin e tarifës është një kërkesë e përsëritur që vjen nga ana e kompanive. Z. Mema u shpreh se pretendimi i tyre është i drejtë pasi nuk ka sens që kompania që nuk ka ndryshime të parametrave teknikë, të ngarkohet financiarisht edhe pse këto kompani janë pjesë e vlerësimit të përbashkët si pasojë e ndryshimit të fushës rezultante. Ai u shpreh se pagesa duhet të kryhet e plotë vetëm nga kompania që ka ndryshim të parametrave teknikë. Z. Mema sugjeroi se kërkesa e operatorëve duhet të merret në konsideratë dhe se udhëzuesi për tarifën duhet të rishikohet. Znj. Fico u shpreh kundër ndryshimit të tarifës, duke marrë në konsideratë punën kolosale që po bëjnë KMR dhe ZMR në këtë drejtim, për pajisjen e antenave celulare me Akt Miratimi brenda një periudhe shumë të shkurtër. Kryetari i KMR-së u shpreh se kompanitë nuk kanë paraqitur argumente të mjaftueshme për ndryshimin e pagesës dhe se këto kërkesa pa argumenta teknikë nuk duhet të paraqiten më në KMR. Kryetari i KMR-së propozoi që ZMR duhet të sjellë argumenta më bindës, duke marrë në konsideratë gjithë historikun se si është marrë ky vendim nga ana e KMR në vitin 2016 për këtë çështje.

Pika e gjashtë e rendit të ditës: Diskutim dhe miratimi i listave të kontrollit për procesin e inspektimit të ZMR.

Anëtarët e KMR -së ishin njohur paraprakisht me email mbi listat e kontrollit të cilat ishin rishikuar dhe përgatitur nga ZMR. Përgatitja e tyre do të shërbejë mbarëvajtjes së punës në procesin e inspektimeve të ZMR-së, si dhe përmirësimit të kualitetit të punës së inspektorëve. Listat e reja të kontrollit kanë marrë në konsideratë ndryshimet e fundit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Gjithashtu përveç reflektimit të ndryshimeve në legjislacion, është bërë dhe një ndarje e tyre duke i përshtatur dhe me sistemin e-inspektimi, si dhe duke marrë për bazë paisjen e cila gjeneron rrezatim sipas specifikave përkatëse të secilës, për çdo fushë aplikimi.

Rishtë që do të sjellë implementimi i këtyre listave të kontrollit në procesin e inspektimit lidhen me:

- rritjen e kualitetit të procesit të inspektimit;
- detajimin e këtij procesi duke adresuar më së miri kërkesat rregullatore specifike për veprimtaritë e ndryshme;
- adresimi i problematikave përkatëse për apratura me specifika të ngjashme; si dhe
- lehtësimi i procesit të inspektimit nga pikëpamja teknike.

Lidhur me këtë çështje kryetari i KMR-së vuri theksin se përderisa subjektet janë të licensuar, nuk duhet të inspektohen nga ZMR, pasi kështu ngarkohen subjektet. Për këtë qëllim kryetari i KMR-së theksoi se inspektimi të bëhet nëpërmjet ISHSH dhe çdo strukturë duhet të ketë një frekuencë inspektimi. Z.Paci sqaroi se prej kohësh po punohet që procesi i licensimit dhe inspektimit të ndahen dhe të jenë dy struktura të ndryshme dhe se zyra nuk është kundër kryerjes së inspektimit nga ISHSH.

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, në përputhje me ligjin Nr. 10433 datë 16.11.2011 “Për inspektimin në RSH”, si dhe rregulloret përkatëse, ka përcaktuar frekuencën e inspektimit

*Almas*

të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues. Z.Paci theksoi se frekuenca e inspektimit merr në konsideratë riskun e burimit të rrezatimit jonizues si dhe performancën e subjektit në të kaluarën. Burimet radioaktive të kategorisë 1 dhe 2, si dhe akseleratorët, inspektohen çdo vit për shkak dhe të riskut që ato mbartin. Burimet radioaktive kategori e 3, si dhe gjeneratorët me reze X (grafi, skopi, CT-skaner etj) inspektohen një herë në dy vjet. Burimet radioaktive të kategorisë 4 inspektohen një herë në tre vjet. Burimet radioaktive të kategorisë 5, grafitë dentare dhe panorameks, inspektohen një herë në pesë vjet, kjo për shkak të riskut të ulët që ato mbartin. Z. Paci sqaroi se plani i inspektimit përgatitet nga ZMR do vit dhe miratohet nga KMR. Në mbështetje të ligjit për inspektimin në RSH dërgohet për miratim dhe pranë Inspektoratit Qendror. Procesi i inspektimit të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues nuk është një proces i thjeshtë dhe duke ju referuar dhe vendeve fqinje ndarja e procesit të inspektimit nga trupa rregullatore nuk ka funksionuar.

KMR miratoi listat e kontrollit si më poshtë:

1. Lista e kontrollit për burime të hapura;
  2. Lista e kontrollit për burime të mbyllura;
  3. Lista e kontrollit për CT-skaner dhe akselerator;
  4. Lista e kontrollit për grafi dentare dhe densitometër;
  5. Lista e kontrollit për grafi industriale;
  6. Lista e kontrollit për panorameks dhe grafi/skopi;
  7. Lista e kontrollit për sigurimin e burimeve radioaktive të kategorisë I,II dhe III;
  8. Lista e kontrollit për transportin e burimeve radioaktive të kategorisë I;dhe
  9. Lista e kontrollit për transportin e burimeve radioaktive të kategorisë II dhe III.
- Listat gjënden bashkëngjitur këtij raportit.

Pika shtatë e rendit të ditës: Miratim mbi mbështetjen për realizimin e temës për studenten e Fakultetit të Mjekësisë.

Anëtarët e KMR-së ishin njohur nëpërmjet emailit mbi kërkesën e shefit të departamentit të Shëndetit Publik, drejtuar ZMR-së për udhëheqjen e studentes së masterit në Fakultetin e Shëndetit Publik, Znj. Bora Hasanago në temën e diplomës mbi efektet e rrezatimit të antenave dhe mbrojtjes prej tyre. Z. Mema u shpreh se shëndeti publik nuk ka lidhje me radiombrojtjen, si dhe propozoi që studentja të dërgohet pranë ISHP, pasi ZMR nuk mbulon efektet në shëndet të rrezatimit jojonizues. Kjo mbështetur dhe në ligjin Nr. 10469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese", ku përcaktohet qartë se efektet në shëndet të rrezatimeve jojonizuese mbulohen nga ISHP. KMR-ja u shpreh që studentja e Fakultetit të Shëndetit Publik të mbështetet nga ISHP në këtë proces.


Pika tetë e rendit të ditës: Informacion mbi seancat gjyqësore për SB Teuta 2

Anëtarët e KMR-së ishin njohur paraprakisht nëpërmjet emailit me dokumentin e përgatitur mbi ecurinë e procesit gjyqësor mbi SB Teuta 2, si më poshtë:

*Amir*

nga mbledhjet e KMR-së, është Znj. Odeta Koja e cila është pjesë e stafit akademik në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në degën e Biofizikës.

Kryetari i KMR-së propozoi që në mbledhjen e radhës të paraqitet një CV e saj, si dhe të krijohet mundësia e një takimi me Znj. Koja nëpërmjet Drejtorisë Juridike në MSHMS.



SEKRETAR  
Rustem PACI



KRYETAR  
Ogerta MANASTIRLIU



*Amor*